



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

V E N D I M  
Nr. 69 , datë 25.09.2019

**Miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor/kullosor për depozitim Materiale inerte (Zhure) në objektin Ashtë**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës, në mbledhjen e tij të datës 25.09-2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nëni 19 pika 1 e ligjit nr. 9385 date 04.05.2005 “Për fondin pyjor“ i ndryshuar”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika 3 ;4 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.7.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, **Këshilli I Bashkisë me shumicë të cilësuar të votave:**

V E N D O S I

1. Miratimin e ngastrës nr.4 për dhënie me qira në një sipërfaqe **Djerre prej 0.8444 ha** në ekonomine pyjore Drin Gjadër Kirë për depozitim te materialeve inerte,Zhure.
2. Afati i dhënies me qera të jetë **9 vjet**.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
5. Ky vendim u shpall sot me datën 30 . 09 2019 .

KRYETARI  
MARK BISHA

